

## SHTATË MBRETËRESHA E SHTATË E MIONËVE – IRINI

Nga Astrit **HYKAJ**

Studiues, Akademia “Rrënjët Tona”

### **PËRMBLEDHJE**

Historia, trashëgimia jonë shpirtërore apo ndërgjegjja kolektive dhe gjithçka tjetër që përbën thelbin e qënies njerëzore, kur vjen fjala te Malësia e Gjakovës, do ishte e pakuptimtë nëse nuk do përfshihej në të edhe mali i Shkëlzenit. Që të flasim për këtë mal, fillimisht duhet të ndreqim emërtimin e tij të shtrembëruar, si shumica e historisë së vendit tonë. Emrin e saktë e gjejmë te Fishta nja njëqind vjet më parë kur ai e përmend si mali Shkëlqen dhe jo Shkëlzen. Më shumë se kudo tjetër rreth e përfaqë kësaj krahine, gjurmët e zanafillës së banorëve vendas dhe trashëgimia shpirtërore mijëra vjeçare duhen kërkuar aty.

*Fjalë kyçe: ndreq, fe, bjeshkë, shtatgushtë, shtatë mbretëresha, shtatë mionë, irini.*

### **ABSTRACT**

History, our spiritual heritage or collective consciousness and everything else that constitutes the essence of the human being, when it comes to the Gjakova Highlands, would be meaningless if it did not include the mountain of Shkelzen. To talk about this mountain, we must first correct its distorted designation, like most of our country's history. The exact name is found in Fishta a few hundred years ago when he mentions it as the mountain Shkëlqen and not Shkëlzen. More than anywhere else around this province, traces of the locals' origins and thousands of years of spiritual heritage must be sought there.

*Key words: repair, religion, mountain with pastures, slender stature.*

### **HYRJE**

Që të flasim për këtë mal, fillimisht duhet të ndreqim emërtimin e tij të shtrembëruar, si shumica e historisë së vendit tonë. Emrin e saktë e gjejmë te Fishta nja njëqind vjet më parë kur ai e përmend si mali *Shkëlqen* dhe jo Shkëlzen<sup>1</sup>. Tani, të gjitha majat e maleve të përbëra nga masive shkëmbore gëlqerore shkëlqejnë. Jezerca shkëlqen, Maja e Hekurave shkëlqen, e kështu me radhë. Mirëpo mali *Shkëlqen* mbase ka të bëjë me shenjtërinë e tij, që do të thotë ndriçon, bën dritë.. Dhe si pasojë Shkëlqen = Dritë. *Shkëlzeni dhe dritat e tij*, gjendet edhe sot e kësaj dite shprehja, që vendorët e kanë në majë të gjuhës. Duke u marrë me shenjtërinë, na lindin vetëvetiu një grusht pyetjesh. A është shenjtëria e përjetshme? Nëse jo sa e lashtë? Kur fillon dhe kur mbaron shenjtëria?

### **SHTATË MBRETERESHA E SHTATË E MIONEVE – IRINI**

Përgjigjet më së miri ndoshta i gjejmë përmes historisë mijëra vjeçare të shqiptarëve si dhe të feve të ndryshme të cilat e kanë begatuar vendin tonë. Kur e vizitova Shkëlzenin në *shtatgusht* të viti 2015, më zuri syrë një pllakë përkujtimore ku shkruhej: 1315-2015, 700 vjetori i shenjtërimin a diçka e tillë!!! Kjo lidhet me gojëdhënë e njohur mes banorëve të krahinës e cila vijon si më poshtë: - Po fluturon një njeri pa krye, - i tha vajza shoqes së vet. – Unë pa krye dhe ti pa sy, - ia priti ai dhe vajza u qorrua. Ai njeri pa krye po fluturone mbi majën e Shkëlzenit. Prej tij ranë dy pika gjaku, ndaj dhe në vendin e shenjtë gjenden dy varre. Ndoshta që atëherë e deri më sot, njerëzit ngjiten në majë të këtij mali me shtatgusht të çdo viti, me një lloj ndjesie peligrinazhi në mendje. Në rastin e Shkelzenit, qasja fetare është e Krishterë. Që do të thotë, një ngjarje deri në përmasa të pabesueshme (*po fluturon njeri pa krye*) pa pritur shndërrohet në një shenjtëri të një vendi i caktuar. Nëse e shohim nga këndvështrimi i ngjarjes dhe asaj se çfarë kuptojmë me fjalën

ngjarje, kjo na sjell ndërmend ngjarjen e kryqëzimit të Krishtit dhe pastaj shenjtërimin e tij. Meqenëse Krishti ishte gjithashtu njeri, dhe si pasojë një ngjarje në histori, shpallja hyjnore duhet të jetë një ngjarje; jo diçka që thotë Zoti, por diçka që ai bën. Nga kjo rrjedh se shpallja nuk është ideore, por vetjake dhe historike. Krishti, personaliteti i përsosur, ngjarja e përsosur, historia e përsosur, është sipas besimit katolik, shpallja e përsosur e Zotit. Krishti pranon të kryqëzohet në emër të fjalës së vërtetë të Zotit, edhe njeri pa krye sipas gojëdhënës vdiq në një luftë të shenjtë. Në Islam, shpallja është ideor dhe vetëm ideore. "Kështu thotë Zoti" është e vetmja formë që mund të marrë shpallja. Islami mbështet idenë profetike të shpalljes së menjëhershëm dhe të drejtpërdrejtë ashtu siç jepet në shkrimet Hebraike. "Kështu thotë Zoti" nënkupton pikërisht atë që thotë sepse në Islam, Zoti nuk e zbulon veten e tij. Duke qenë përsosuri, Ai nuk mundet kurrë të bëhet qëllim i të njohurit. Por ai mund dhe zbulojë vullnetin e Tij, pra përmes fjalës. Ndonëse qasja është e Krishterë, praktika e besimit të ky vend i shenjtë gjithsesi ka një mospërputhje me krishtërimin ngaqë vendi i shenjtë në Shkëlzen nuk është as kishë, dhe aq më tepër xhami. Aty nuk gjen as hoxhë, as prift, as rabin. Dhe deri kohët e fundit mund të gjeje vetëm dy varre me gur të thatë në qiell të hapur.

Qasja Islame nga ana tjetër nuk e pranon ngjarjen. Pra nëse ngjan me diçka atëherë Shkëlzeni ngjasojnë me ngjitjen e Moisiut në mal për të folur me Perëndinë apo me Orakullin e Dodonës ku shqiptarët shkonin në mal dhe luteshin: *O Zot do dona*. Shtjellimin e mospërputhjes mund ta kërkojmë përmes historisë së feve, pikërisht gjatë asaj periudhe kohore të shfaqjes së njeriut pa krye sipas gojëdhënës, pra në fillim të shekullit të katërmëdhjetë. Përderisa qasja është e Krishterë, edhe praktika duhej të ishte e tillë, por nuk është. Në vitin 1241, me vdekjen Xhon Asen II-të, prijësi të Perandorisë Bullgare, gadishulli Ilirik bien nën sundimin e shkijeve, përkatësisht të dinastisë Nemanja<sup>ii</sup>. Në vitin 1315 tashmë shqiptarët prej kohësh ishin pjesë e kësaj perandorie, sundimi i cilës zgjati deri me 1368 kur prijësi Balsha pagëzohet si katolik dhe veriu i shqipërisë sundohet nga familja e tij. Nëse marrim parasysh vitin 1315, praktika kurrsesi nuk mund të ishte as Ortodokse për shkak të armiqësisë shqiptaro-sllave. Në vitin 1217, Papa Inocenti III mesa duket u besoi shkijeve më shumë se ç' duhet dhe kurorëzoi Stefan Uroshin përmes përfaqësisë së tij. Vatikanin nënvlerëson vëllanë e tij të vogël, Shën Savën, i cili me lehtësi bind patriarkun grek që të njohë kishën e pavarur Serbe. Më 1220 Shën Sava emërohet kryepeshkopi i parë i kishës së pavarur serbe. Më 1312, mbreti i Serbisë Stefani IV fillon përndjekjen e latinëve nga gadishulli. Që në atë çast fillon edhe ndëshkimi i shqiptarëve siç edhe e tregojnë ligjet e Dushanit të botuara 1349, si një kundërshtarë të egër të "Heretikëve Latinë"<sup>iii</sup> dhe si rrjedhojë të shqiptarëve. Ndaj dhe në vitin 1315, Katolicizmi do u jetë dukur shqiptarëve si diçka e largët dhe tepër e rrezikshme, aq më tepër shqiptarëve përreth Shkëlzenit në mungesë të plotë të ndonjë kisha katolike. Si pasojë, praktika nuk mund të ishte as katolike.

Nga ana tjetër, qoftë qasja, qoftë praktika, në viti 1315 nuk mund të ishin kurrsesi Myslimane për vetë faktet historike të përhapjes së Islamit në trojet shqiptare. Në vitin 1352, duke përfutur nga lufta civile brenda perandorisë Bizantine, Osmanët shkelën për herë të parë në Europë, përkatësisht në gadishullin e Galipolit në Thrakën lindore<sup>iv</sup>. Perandori Xhon Kantakuzeni për të mbrojtur fronin e tij nga sulmet e Xhon Paleologut V-të, u kërkoi ndihëm Osmanëve, duke i lejuar të vendosen të Galipoli, pjesa lindore e Greqisë së sotme. Më 1361 sulltan Murati II pushton Adrianopojën. Por deri më atëherë Islami s' ishte i njohur në gadishullin Ilirik. Sërisht, më 1315, Islami ishte praktikë e panjohur. Ndonëse qasja është e Krishterë, praktika e besimit është Sufiste. Bektashizmi është thjesht një rend Sufist si pjesë e njërës prej shumë degëve mistike të Islamit. Rendi fetar i këtij besimi është themeluar në shekullin e trëmbëdhjetë nga Haxhi Bektash Veli (1248-1341), dhe në fillim të shekullit të katërmëdhjetë pati përhapje të gjerë, përmes emisarëve të dërguar nga vetë Haxhi Veli. Gjithashtu, është bekimi i parë që merrnin Jeniçerët, ose ushtarët elitë të perandorisë Osmane në fillimet e tyre, e cila që atëherë u kthye në një traditë. Ata vinin kryesisht nga gadishulli Ilirik, vende me besim të Krishterë dhe kur ktheheshin, ndonëse rrallë, merrnin me vete edhe mësimet Bektashiane. Pra

*njeriu pa krye* mund të jetë përpjekja e misionarëve sufistë të ardhur në Shkëlzen për t'i dhënë shenjëtërimin ezistues të kësaj maje. Një qasje Bektashiste. Dymbëdhjetë dervishë dhe misteret e tyre madhështore. Mirëpo, Sufizmi megjithatë njihet edhe më heret si degë me vete e Islamit. Aftësitë e çuditshme të njerëzve të veçantë kanë mahitur gjithmonë, dhe të tillë njerëz në lashtësi njiheshin si priftërinj. Përfytyrimi tekembramna është më i fuqishëm se e verteta. Reklama më e mirë është fjala e gojës. Dhe në kushtet e shqiptarëve asokohe mbase kjo ka qenë mënyra më e përshtatshme e shpalljes së shenjëtërimin, pa nevojën e kishave, ngaqë shumica dërrmuese në mos të gjithë ishin analfabet, dhe shqiptarët ndryshe nga fqinjët nuk kishin kishën e tyre të pavarur por vareshin nga Vatikani i largët. Çdo ngjarje duhet parë brenda epokës kur ajo ndodh. Edhe besimin duhet parë më këtë sy, qoftë shpallja qoftë praktikata.

Lidhur me historinë e feve, një teori shumë e thellë filozofike është e paraqitur shkurtimisht nga Prof. B.E.Meland në vitin 1961. Në një shkrim ai i vlerëson fetë në thelb si një të vetme, jo në nivelin e doktrinës ose simbolikës, shpalljes apo praktikës por, në nivelin e një nënshtrese më të thellë që është e vërtetë - dhe kërkon të arrijë, pajtojë ose gjykojë shpalljet e feve të ndryshme në nivelin e simbolikës duke iu referuar këtij realiteti më të thellë që është i përbashkët për të gjithë. Arritja e kësaj simbolike të pajtueshme bëhet vetëm brenda kulturës dhe prekshmërisë së caktuar të një vendi, me arsyetimin se: ngrehina e besimit dmth, e veçanta është kaq thellësisht organike me sqarimin e njeriut në çdo kulturë dhe aq shumë prej saj është nën nivelin ndjesor të vetëdijësisimit saqë ecuritë e mendimit të njeriut nuk mund të shpëtojnë ose kapërcejnë kushtëzimin e kulturës vendore, sado të stërvitura të jenë. Prandaj njeriu e nje Zotin, gjendjen parake, nëse jo natyrshëm, atëherë me anë të shpalljes.

Nëse thellohem në historinë e besimeve fetare jemi në gjendje të pajtohemi edhe më shumë me mendimin se fetë, në thelb janë si një e vetme. Në shekullin e parë të Islamit, shumica më e madhe e ithtarëve të tij kishin qenë të krishterë në mosmarrëveshje me krishterimin ortodoks në lidhje me atë se çfarë është dhe çfarë nuk është shpallje dhe fe e Jezu Krishtit.<sup>v</sup> Islami është sigurisht një revolucion i krishterë me po aq lidhje me Krishtin sa ç'mund të pretendojë edhe të krishterimi ortodoks. Ne nuk duhet të mashtrohemi nga fakti se revolucioni islamik brenda krishterimit shkoi përtej asaj që kishte vendosur të përmbushë fillimisht. Është e vërtetë se Islami nuk ishte më i ri sesa feja e Krishtit dhe ka të bëjë edhe me fenë e hebrenjve. Në rrjedhën e përhapjes së Islamit në lindje të dy lumenjve (Tigër dhe Eufrat) ku arabizimi nuk shkoi krahas për krahas me islamizimin, kuptimet kuranore pësuan ndryshime. Kështu që, ishte e natyrshme që midis atyre, vetëdija e të cilëve nuk ishte qeverisur plotësisht nga kategoritë e vetëdijes arabe, të fillonte përhapja e një lëvizje, e cila e kuptonte Zoti si një gjendje pushteti apo sjellje, të joshur mendërisht ose nga Ortodoksizmi, fetë e Persisë dhe Indisë, ose nga Jahudizmi i atyre Hebrenjve që e mendonin Zotin e tyre në kushtet e një njeriu. Duke gjykuar nga lloji i arsytimeve mund të themi se të ndërruarit nga Hebrenj në Muslimanë duhet ta kenë furnizuar udhëheqjen mendore të atyre që e kuptonin Zotin në kushtet e një njeriu. Të njëjtën gjë mund të kenë bërë edhe ata që u shndërruan nga Myslimanë në Sufistë.

Doktrinat fetare të Hebraizmit, Krishtërimin dhe Islamit mund të jenë të rrepta, dhe të mbrojtura me fanatizëm nga klerikët dhe institucionet, por besimet fetare në vetvete nuk janë të tilla. Deri tani jemi disi të qartë me qasjen dhe praktikën megjithatë nuk i jemi përgjigjur një pyetje themelore: Përse shtatë dhe Përse gusht?! Mos vallë ato vajzat që panë teksa fluturonte një njeri pa krye shkuan dhe regjistruan datën menëherë duke thënë se e pamë sot me shtatë Gusht. Po ku e regjistruan? Edhe nëse gojdhëna është e vërtetë, data dhe muaji nuk mund të jetnë të tilla, dhe se që fjala për të marrë dhenë, fillimisht kërkon kohë. Mirëpo kjo vetëm sa ma shton bindjen se data dhe muaji kanë qenë aty prej shekujsh, dhe askujt si ka interesuar ndryshimi apo përcaktimi i tyre. Besimtarët mund të jenë ngjitur në malin e Shkëlzenit me *shtatëgusht*, dhe këtë misionarët Sufistë e kanë pasur gati, pa lindur nevojë ta ndryshojnë.

Atë çfarë janë përpjekur të bëjnë dhe që ia kanë arritur, është qasja fetare, përvetësimi i kësaj date dhe kthimi i saj në një ditë të shënuar Bektashinjësh, përmes gojëdhënës së njeriut pa krye, pasi që dervishët bëjnë mrekullira edhe të tilla madje siç është fluturimi pa krye! E parë nga ky këndvështrim, dalim në përfundimin se kemi të bëjmë thjesht me zëvendësimin e dokeve, zakoneve dhe besimeve të lashtësisë me një doktrinë të re fetare në rastin tonë me atë Sufiste. Po a mund të kenë mbijetuar besimet e lashtësisë deri rreth viteve 1315? Përgjigja është PO, dhe për këtë mjafton të përmendim faktin se për të zëvendësuar Zeusin dhe dymbëdhjetë perënditë e Olimpët, me Krishtin dhe dymbëdhjetë shenjtarët e tij u deshën të paktën treqind vjet që nga vdekja e Krishtit. E njëjta gjë ka ndodhur me Islamin. Kurani ka filluar të zbatohet aty rreth viteve 900 pas erës sonë, pra të paktën treqind vjet pas shpalljes. E nëse një besim i lashtë ka mbijetura në një vend të thellë e të përhumbur si Shkëlzeni dhe rreth tij deri në fillimet e shek 14-të, askush nuk ka përse të çuditet. Por, le të ndalemi te data dhe muaji, pikërisht për të cilën unë dua të flas, duke marrë shkas nga njohja me një ndër zbulimet e shumta të Niko Stillos.

Duke përdorur alfabetin Etrusk, ndër të tjera ai ka deshifruar edhe një mbishkrim gjetur në qytetin e Bylisit, dhe që ruhet në Muzeun e Apollonisë, në vendin tonë. Pllaka në të cilën ndodhet mbishkrimi i përket shekullit të dytë pas Krishtit. Mbishkrimi përmban emrin e perëndeshës etruske VENUS (*VENVUST*). Në pasqyrat etruske përveç se e vizatuar dhe e emëruar Venus, ajo shoqërohet edhe me simbolikën e posaçme, me katër kryqet. Dhe gjithashtu ajo gjendet edhe në afreske të ndryshme. Në pllakën e Bylisit, gjithmonë sipas Stillos mes tjerash shkruhet: Cecilia e Venusit të Madh, shumë e lartësuar prej Dionisit, sy të verbër, tingujt e akustik. Lidhja mes këtyre hyjnive SESILIA – VENUSI – DIONISI, si dhe cilësimet e emertesave që janë veçoritë karakteristike të hyneshës më të madhe të toskërisë Venusit ose e njohur ndryshe më përpara si Afërdita, pra zëvendësimi i emrit të lashtësisë me një emër Romak si tingujt akustik apo sytë e verbër, ose aftësia e përdorimit të syve.<sup>vi</sup> Në kohë të ndryshme dhe në vende të ndryshme kjo perëndi është emëruar në mënyra të ndryshme, që nga lashtësia e deri në mesjetë, dhe kjo në vetvete përbën vështirësi në gjetjen e këtyre emertesave dhe lidhjeve logjike.

Le ta fillojmë me mozaikun e Dionisin të vogël, një mozaik romak të shek. IV p.e.s të sygjëruar nga lidhja midis Sesilia-Venus-Dionisi, në pllakën e Bylisit dhe që lidhen me njëra-tjetra përmes cilësive si tingujt apo sytë. Për të vazhduar me bazilikën Shën Cecilia në Romë, ku kemi dy piktura të Sesilias. Një shtatore në mes e sipër duke mbajtur një harpë, dhe një në këmbë mes Papa Paskalit dhe Shën Palit. E njëjta hyneshë e lashtësisë (Aferdita -Venusi) gjendet e pasqyruar në mozaik, monedha të trevave të mesdheut që u përkasin dorëve, jonëve, etruskëve, relieve, statuja, pasqyra etruske, e deri te ikona kishtarë, dhe shkrime nëpër manastire, me një alfabet që nuk është as sllavisht as greqisht, po është vendor, Ilirisht.

## **CECILIA - SELENA – ISIS – IOS - PELAGIA- THALASA - që ka të bëjë me detin**

### **SHTATA mbreteresha e Shtatë e Mioneve - IRINI**

Në katedralen e Shën Markut në Venecie, gjendet ikona mesjetare e *Shtatë Gushtes*. Teksti është i shkruar me të njëjtën gjuhë dhe me të njëjtin alfabet si teksti në mbishkrimin e lartpërmendura në Bylis. A ka lidhje me Cecilian? Një statujë bronxi Italiane që daton një shekull para Krishtit e që gjendet në muzeun e Berlinit, titulluar HENA, na paraqitet duke mbajtur me të dyja duart një velë prej nape, të cilën e fryn era. Mbi kokën e saj është pikërisht gjysëm Hëna, sikurse edhe te një prej pasqyrave etruske. Selena është dijetarja që ka shpikur rrotën dhe velën e anijes. Statuja e mermerit, SELENA- LUNA-HENA, në muzeun e Vatikanit, ku një gruaja që sipas arkeologëve është perëndesha ISIS ose PELAGIA lëviz një anije me një rrobë të fryrë

që i rrin përpara si velë. Imazhi i Agia Pelagia gjendet edhe në manastirin e Graçanicës në Kosovë. Simboli i lopes, furrës dhe gjysëm hënës janë të lidhura sërish me perëndeshën ISIS.

Ikona Shën Pellagian, dhe emri Shtata që lidhet me ISIS apo CECILIA, që janë hyjni pellazge të kristianizuara. Shtata gjendet edhe te Shën Irini, e cila njihet si Shën Cecilia. Por, Shën Pelagia ishte mbretëresha e shtatë e Mionëve, që gjendet në dy ikona: njëra SCA(shtat)PELAGIA dhe tjetra SCA CECILIA. Dorianët e Sirakuzës na kanë lënë treshëgimi monedha me kokën e një gruaje, ku shkruhet: IO-S. Thjesht kemi paraqitjen e një prej hyjneshave më kryesore të botkuptimit pellazg, dhe që për lashtësinë njihet edhe si ISIS (gruaja e OSIRIT, Nëna e HORUSIT, shpijsja e e Velave, e Harpes, e vet Jetes, e lindur në ditën e katërt (ndaj dhe shoqerohet me kater delfin), mbretresha e shtatë e Mioneve ndaj dhe i thonë dhe Shtata e Gushtit, etj. NDRYSHE kjo hyjneshe quhet VIRGJERESHA E BOTES - SHEN MARIA. ka qenë dhe Shen ELENA apo e bukura ELENE, madje një mendimtar i madh ka thezen se vet 'Lufta e Trojes' nuk ka qenë për rrëmbimin e një gruaje por për rrëmbimin e kësaj Hyjneshe të bukur HELENËS.

## E BUKURA ELENË

E Gjithëditura Shtatë-Gushtja e Mionëve / Perëndia e Olimpmit me shumë emërtesa / e Shenjta Kristiane me shumë emërtesa. *Virgjëresha botërore / Shën Mëria*, të cilën e gjejmë ende sot nëpër ikonostatet e kishave dhe manastireve me po ato emra dhe me po ato alfabete të asaj popullsije që jo vetëm barti kulturën hyjnore por e transmetoi në vazhdimësi, me shqipfolësit si shqiptar, arvanitas, thesprotas –pasi grekët e lashtë nuk janë çbërë por janë, jemi këtu. Shtatëgushti në Shkelzen është dita që kujtojmë mbretëreshën e shtatë të Mionëve, më vonë e njohur si Maria (nëna e Krishtit), ditëlindja e së cilës festohet në masë kudo në vendet e Krishtera, sidomos në Greqi gjatë muajit Gusht. Pra shtatë = mbretëresha e shtatë dhe Gushta = ditëlindja e Shën Marisë. E njëjta mbretëresh e cila ishte aq e rëndësishme, saqë u emërua në dy mënyra të ndryshme për t'u mos harruar. AGIA PELAGIA e Manastirit të Graçanicës është mbretërsesha e shtatë e Mionëve (Qytetërimi i Kretës). Pra, e shtata e Mionëve dhe ajo që ka lindur në Gusht (Shën Maria) = Shtatgushta. Bashkë me shtatgushtën mërgimtarët nga jugu i thellë i gadishullit Ilirik, morën me vete drejt veriut jo vetëm besimin d.m.th *Shtatgushtën*, por edhe xhubletën, edhe lahutën, edhe plisin, edhe mënyrën pellazgjike të ndërtimit të mureve.

Çdo ditë e më shumë, për fat të mirë, rëndësia e Zotit për çdo pikëpamje dhe element *hapësirë-kohë* (vazhdimësia katër përmasore) po rizbulohet, duke përgatitur kështë një mohim të atij farloj besimi fetar të shenjtë të paprekshëm, të veçantë apo të të veçuar. Në vend të kësaj, po zbulohet një besimtari se çdo gjë po zbulohet, një besimtari e cila nuk qëndron në atë që prania e diçkaje është thjesht një porosi. Besimet fetare në thelb janë të njëjta, siç thamë edhe më lart, prandaj doktrinë fetare të paprekshme nuk ka. Feja në vetvete, megjithatë, nuk është një veprim (veprim i të besuarit, ose takimit me Zotin, ose i pjesëmarrjes), por është një përmasë e shtuar e çdo veprimi. Paçim bekimin e Zotit, themi ne në çdo gjë të rëndësishme që bëjmë, kjo është përmasa e shtuar e veprimit. Feja nuk është një gjë, por një fushëpamje me të cilën është e veshur çdo gjë. Është përmasa më e lartë dhe më e rëndësishme. Vetëm për atë përmasë të lartë dhe më të rëndësishmen veprimi merr një kuptim vetjak, si qëndrim brenda rrethanës fetare-kulturore, në të cilin ka ndodhur. Pra, *njeri pa krye*, ka kuptim vetëm për banorët vendas, si dhe rrethanën hapësirë-kohë.

Deri më tanë, shumica e vëmendjes së hulumtimit të historisë së feve i është kushtuar Judaizmit, Krishtëritimit dhe Islamit. Jo ngaqë fetë primitive dhe të lashta nuk mund të mbartin në vetvete shumë mësim të mëdha. Por, sepse ato janë shumë më të padepërtueshme sesa grupi tjetër i mirë studiuar që sapo e përmendëm, dhe kjo për shkak të pengesave gjuhësore, largësisë kohore, të ndryshimit të gjerë midis

kategorive të tyre dhe tonave. Shtatgushta nuk është kurrsesi e vetmja lidhje e Shkëlzenit apo alpeve Shqiptare në tërësi me lashtësinë. Jo shumë larg majës së Shkëlzenit gjendet një vend i emërtuar PIRRA. Ky vend është një ndër më të vështirat për tu shkelur me këmbë, ndaj sa herë që themi pirra, kemi nënkuptuar diçka të vështirë. Ne mund të mos e dimë kuptimin e saktë të fjalës pirr apo pirra, apo PIRRO, por sipas gegnishtes ne e dimë saktësisht kuptimin e fjalës së kundër të *pirrë* që është *spirrë* (e thyeshme) e që përdoret gjerësisht në disa mënyra madje, spirrë – spirroje – i spirravun, etj. Pra, nga kjo mund t'ia lejojmë vetes të besojmë se pirrë do të thotë i pathyeshëm. Përveç emrit në atë vend rritet edhe një lloj bari i quajtur bar pirrak, pra i fortë i pa mundur të shkulet apo këputet. Që një emër të bëhet popullor deri në atë masë sa që të emërtohen edhe njerëzit duhet të ketë egzistuar dhe përdorur për qimdra vjet që të bëhet pjesë e kulturës së atij vendi. Emri pirrë – pirra është përdorur shumë kohë më përpara se të lindë Pirroja i Epirit, pasta të jetë përdorur si emër burrash. Sa për shkronjën O në fund ajo mund të sqarohet sipas pasthirmave bir-o, djal-o Mar-o etj, pra Pirr-o, pra I PATHYESHËM. Dhe jo më kot është quajtur edhe Pirro Burri, pra burri i pathyeshëm.

## PËRFUNDIME

1. Dhe së fundmi, Bjeshkët e Nemuna, si pjesë përbërëse të Alpeve, jo shumë larg Shkëlzenit. Gjatë përcaktimit përfundimtar të kufijve të Shqipërisë, Mbreti Zog u detyrua që të zgjidhte, o krahinën e Vermoshit, o manastirin e Shën Naumit. Ai zgjodhi Vermoshin me vargmalin Marlulë – Maja e Brojës, deri në majën e Zhihovës që përbën skajin verior të Shqipërisë.
2. Mbreti Zog është kritikuar jo pak për këtë zgjedhje, por në të vërtetë për trashëgiminë shpirtërore të kombit ka shumë më shumë rëndësi sesa Shën Naumi.
3. Mes vargmaleve të Vermoshit dhe bjeshkëve të Pejës, shtrihen Bjeshkët e Nemuna. Të nemuna nga Muji, të vajtuara nga Ajkuna për birin e tyre të rënë në këto bjeshkë.
4. Vetë Eposi i Kreshnikëve përmes bëmave nuk është gjë tjetër veçse përpjekje për të ringjallur lashtësinë në ndërgjegjen kolektive të mbarë kombit shqiptar. Po çfarë dimë ne më shumë sesa faktit që janë të nemuna (mallkuara) prej kreshnikëve?!
5. Nemeses nënkupton dy koncepte hyjnore<sup>vii</sup>: E para, ajo është një perëndeshë që adhurohej në Atikë, vajza e natës. E dyta, është *ndjesia e një mospajtimi në zemërim e sipër*, më vonë mishëruar në formë e një perëndeshë me trup femre. Mos pajtim në zemërim e sipër – NEMA (mallkimi) – *tu shkimtë drita ty o mori Hanë....*
6. Një shpjegim tjetër i fjalës Nemeses është shpagim hyjnor, që ndryshe do të thotë të zëntë mallkimi i dikujt (*nema*), por për të të zënë, ai që mallkon duhet të ketë fuqi hyjnore. Edhe në këtë rast kemi të bëjmë me të njëjtën gjë: *Nema*. Atika është e shquar për popullsi shqiptare edhe sot e kësaj dite. Arvanitasit e Atikës janë gjithnjë element përbërës të formëzimit të Helenizmit, që nga lashtësia deri në ditët tona.

## STUDIME MBËSHTETËSE DHE REFERENCA

1. Gjergj Fishta: “Mrizi i Zanave”
2. Wadham Peacock: “ALBANIA – the foundling state of Europe”
3. Wadham Peacock: po aty.
4. THE OXFORD WORLD HISTORY OF EMPIRES. Volume II, The history of empires.
5. Prof. ISMAIL AL FARUQI. Harvard University, MA in philosophy: *History of Religions: Its Nature and Significance for Christian Education and the Muslim-Christian Dialogue. (selected essays)* IIIT – London – Washington.

6. Mir njohje Eva Brinja.
  7. Encyclopaedia Britannica.
-